



Data: 22.06.2020 Ref.: 580/2020

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 80-të, të mbajtur më 01 Prill 2020, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (Nr.2033/19H, datë 23.10.2019) për riakreditim të programit të studimit:
 - Mami, BSc, 180 ECTS
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë (Nr.2033/19H, datë 23.10.2019) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim të programit të studimit: Mami, BSc, 180 ECTS.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Sipas nenit 26, pika 5.3.11 e UA për Akreditim, *"Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është paraparë më këtë UA, (Infermieri BSc, Mami, BSc, Gjuha e Shenjave BSc), do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i arsimit të lartë do të siguron AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar"*.

Për programin e studimit: Mami, BSc, 180 ECTS, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka paraparë këta persona si bartës të programit: Mr. Sc. Leonora Hajrizaj (MA në Menaxhment Shëndetësor), Mr. Sc. Blerta Kryeziu (MSc në Kujdes Shëndetësor), Dr. Sc Vlora Ibishi (PhD në Shkenca Mjekësore-Mjekësi

Klinike), Dr. Sc Brikena Dacaj (MA në Shkenca Mjekësore), Dr. Sc Pranvera Zejnullahu (Biomjekësi dhe Shkenca Shëndetësore), Dr. Sc Vjosa Zejnullahu (PhD në Shkenca Mjekësore-Mjekësi Molekulare dhe Gjinekologji).

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Bazuar në nenet e referuara më sipër KSHC ka verifikuar te gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit. Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KSHC-së të mbajtur me 01 prill 2020, dhe pas shqyrtimit të dosjes per secilin staf akademik, u konstatua që bartësit të prezantuar më sipër në këtë program nuk i përmbushin kriteret ligjore për të qenë bartës të këtij programi, sepse nuk janë të fushës relevante.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore te sqaruara me lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Mami BSc*, 180 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë